



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.A.nr.10/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi kryesuese, Hidajete Gashi Alaj dhe Kujtim Pasuli, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e [REDACTED] me vendbanim në [REDACTED] parashtruar ndaj Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos shqyrtimit të kundërshtimit dhe refuzimit të aplikimit për të votuar si votues jashtë Kosovës, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 01.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET ankesa ZP.Anr.10/2026 datë 31.05.2026, e parashtruar nga [REDACTED] me vendbanim në [REDACTED] parashtruar kundër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos shqyrtimit të kundërshtimit dhe refuzimit të aplikimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 07 Qershor 2026, në mungesë të interesit juridik.

A r s y e t i m

Me datë 31.05.2026, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga nga [REDACTED] me vendbanim në Zvicër, në të cilën pretendohet se e njëjta ka aplikuar për regjistrim si votues jashtë Kosovës për zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës. Parashtruesja e ankesës thekson se KQZ e ka refuzuar aplikimin e saj me arsyetimin se mungonte adresa e banimit. Parashtruesja e ankesës menjëherë pas marrjes së njoftimit nga KQZ ka parashtruar kundërshtimin dhe ka ofruar dëshmi shtesë të vlefshme të cila e vërtetojnë adresën e saj të banimit jashtë Kosovës. Tutje, thekson se i njëjti rast ka ndodhur dhe me bashkëshortin e saj, i cili kishte të njëjtin arsyetim për refuzim dhe pas dërgimit të provave me rastin e kundërshtimit, kërkesa i është aprovuar, ndërsa në rastin e ankueses nuk është trajtuar fare. Prandaj, e njëjta kërkon shqyrtim urgjent të rastit, verifikimin nëse kundërshtimi është pranuar dhe shqyrtuar, korrigjimin e çdo gabimi administrativ dhe mundësimin e realizimit të së drejtës së saj për votim.

Parashtruesja në ankesë ka bashkangjitur dëshmitë si kopje e letërnjoftimit, email-at lidhur me kundërshtimin, refuzimin e kundërshtimit, dhe dëshmi lidhur me thirrjet të kontaktit me KQZ.

Në përgjigje në ankesë, KQZ-ja ka theksuar se pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Kundërshtimi Administrativ i paraqitur nga pala ankuese është aprovuar nga KQZ, lidhur me votimi jashtë

Kosovës dhe palës i është dërguar zarfi me fletëvotim në adresën ku ka aplikuar për votim jashtë Kosovës. Si provë ka bashkangjitur dëftesën e regjistrimit.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesja, gjeti se:

- Parashtrueses së ankesës i mungon interesi juridik.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me datën 18 Maj 2026 KQZ e ka refuzuar aplikimin e parashtrueses së ankesës me arsyetimin se i mungon dokumenti që dëshmon adresën e banimit. E njëjta menjëherë pas marrjes së njoftimit nga KQZ ka parashtruar kundërshtim administrativ në KQZ. Megjithatë, pala para se të pranoj përgjigje mbi kundërshtimin, ka parashtruar ankesën ZP.Anr.10/2026 me të cilën pretendon mos shqyrtimin e kundërshtimit dhe refuzimit të aplikimit.

Me rastin e shqyrtimit të ankesës PZAP iu ka drejtuar KQZ-së për të dhënë përgjigje lidhur me arsyet e refuzimit të palës ankuese për tu regjistruar si votuese jashtë Kosovës. KQZ me anë të përgjigjes në ankesë ka konfirmuar se pas shqyrtimit të kundërshtimit administrativ kërkesa e palës ankuese është aprovuar dhe e njëjta është e regjistruar për votim jashtë Kosovës, ku si dëshmi kanë bashkangjitur dëftesën e regjistrimit për votim jashtë Kosovës me emrin e parashtrueses së ankesës.

Paneli gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë vlerëson se në rastin konkret palës ankuese i mungon interesi juridik për parashtrimin e ankesës, pasi që e njëjta është e regjistruar nga KQZ-ja, për votim dhe e njëjtat gjendet në listën e votuesve jashtë Kosovës.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë bazë dhe nga arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 13 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 01/2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 115 paragrafi 1 të Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.A.nr.10/2026 më datën 01.06.2026



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.